



---

## Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të shtatë të rregullt të BISHZ-së më 20.11.2004

---

**Vendi:** Restorani "Piazza Pizzeria" (kati dytë) në Schönbühl-Bernë

**Data:** E shtunë, 20 nëntor 2004 / 17.00-19.30

**Protokoli:** Abas Fejzullahi (sekretar)

**Pjesëmarrës:** Rreth 40

---

### Pikat e rendit të ditës:

#### Pjesa e parë: Kuvendi (17:00 – 18:20)

1. Hapja e Kuvendit dhe përshëndetja e të pranishmëve (Sinollah Shehu)
2. Fjala hyrëse dhe vështrimi i shkurtër i punës shtatëvjeçare të BISHZ-së (Ahmet Xhigoli)
3. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 15.11.2003 - 19.11.2004 (Ahmet Xhigoli)  
Diskutim i hapur (Të gjithë)
4. Ndarja e mirënjohjeve (Ahmet Xhigoli)
5. Të ndryshme (Të gjithë)

Mbyllja e Kuvendit (Sinollah Shehu)

#### Pjesa e dytë: Promovimi i librit "Loti Alpin" i autorit Agim Shehu (18:30 – 19:30)

1. Hapja e promovimit dhe fjala hyrëse (Abas Fejzullahi)
2. Paraqitja e shkurtër e jetëshkimit të shkrimtarit Agim Shehu (Ahmet Xhigoli)
3. Leximi i disa pjesëve të librit (Agim Shehu)
4. Diskutim i hapur (Të gjithë)  
Mbyllja e promovimit (Abas Fejzullahi)

#### Pjesa e tretë: Darka e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar (19:30 – 21:30)



## Pjesa e parë: Kuvendi (17:00 – 18:20)

### 1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit

Sipas rendit të ditës të përshkruar në ftesë, inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të shtatë të rregullt dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti sekretarin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë, dr. sc. Sefedin Xhemajlçe, shkrimtarin zotëri Agim Shehu dhe bashkëshortën e tij zonjën Zana Shehu, kryetarin e komunës së Bujanocit nga Kosova Lindore zotëri Nagip Arifin, kryetarin e bashkësisë lokale të Tërnocit zotëri Galip Beqirin, gazetarin e gazetës Bota Sot zotëri Rexhep Rifatin dhe gazetarin e Zërit Ditor, zotëri Blerim Shabanin.

Të ftuar ishin edhe ambasadori i Republikës së Maqedonisë, zotëri Mahmut Ibrahim, ambasadori zotëri Vladimir Thanati nga Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë selisë së OKB në Gjenevë, të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mund të vijnë.

Në vazhdim, z. Sinollah Shehu lexoi rendin e ditës dhe e luti kryetarin e BISHZ-së, dr. sc. Ahmet Xhigoli që të fillon me fjalën hyrëse dhe vështrimin e shkurtër të punës shtatëvjeçare të BISHZ-së dhe pastaj me paraqitjen e raportit të punës njëvjeçare të Shoqatës.

### 2. Fjala hyrëse dhe vështrimi i shkurtër i punës shtatëvjeçare të BISHZ-së

Në këtë pikë, dr. sc. Ahmet Xhigoli, kryetar, i përshëndeti të pranishmët dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në Kuvendin e shtatë të Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër me seli në Bernë dhe paraqiti një vështrim të shkurtër por mjaft të thukt të punës shtatëvjeçare të Shoqatës. Më tutje, ai, theksoi që për këto shtatë vite të kaluara, në këtë shoqatë janë bërë përpjekje dhe vetmohime të mëdha dhe janë arritur rezultate të konsiderueshme si dhe në masë të madhe janë realizuar detyrat e parashtruara në programin e saj. Me këtë rast, pjesëmarrësve ua shpërndau falas numrin e parë të Resistës shkencore, kulturore, artistike dhe sportive Bashkimi (ISSN 1424-6554) dhe i ftoi të interesuarit për bashkëpunim.

### 3. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 15.11.2003 - 19.11.2004

Dokumenti "Raporti vjetor nr. 7" i BISHZ-së prej 15.11.2003 deri më 19.11.2004 u është shpërndarë të pranishmëve.  
Aprovimi i raportit të punës për periudhën 15.11.2003 – 19.11.2004

Dr. sc. Ahmet Xhigoli, ju drejtua të pranishmëve se do bëjë disa sqarime lidhur me Raportin vjetor të punës për periudhën 15.11.03–19.11.04. Më tutje, ai tha që ky raport është i strukturuar në 8 kapituj. Shkurtimisht i njoftoi të pranishmit për përmabjtjen e secilit kapitull dhe në veçanti më tepër u ndal në kapitujt 2, 3 dhe 4. Pas referimit të tij, pyetje nuk pati. Po ashtu, z. Xhigoli i njoftoi të pranishmit që miratimi i këtij raporti do bëhet në mbledhjen e ardhshme të kryesisë, dhe i luti të gjithë të pranishmit që ta lexoni raportin e përmendur dhe vërejtjet, sygjerimet tuaja ti bëni të njohura dhe të na i dërgoni ato sa më parë, kështu që të përfshihen në versionin përfundimtar të këtij raporti.

#### Diskutim i hapur

Dr. sc. Ahmet Xhigoli, i falënderoi të gjithë për interesimin e treguar dhe ftoi kush don ta marr fjalën për të diskutuar apo përshëndetur.

- Fjalën e mori sekretari i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë, zotëri Sefedin Xhemajlçe, pas prezentimit, në mes tjerash tha: Si diplomat në emër të Ambasadës së Shqipërisë dhe të ambasadorit i cili s'ka mundur të jetë sot në mesin tuaj nga se ka qenë i zënë me punë, ju përshëndes përzemërsisht dhe u dëshiroi suksese në punën tuaj intelektuale shumë të çmuar. Edhe unë si diplomat dhe në veçanti si doktor shkence i Matematikës (ku kam doktoruar në Paris të Francës) vërejtja punime shkencore në revisten tuaj Bashkimi, kjo më gëzoi shumë dhe u dëshiroi punë të mbarë dhe sukses në mirëmbajtjen e lidhjeve me intelektualët dhe mërgatën në përgjithësi.



- Fjalën e mori për diskutim, mysafiri i ftuar, zotëri Nagip Arifi, kryetar i Komunës së Bujanocit në Kosovën Lindore i cili në mes tjerash tha: Të nderuar intelektual, vëllezër dhe motra, unë jam kryetari i parë shqiptar në Komunën e Bujanocit në historin e Kosovës Lindore dhe jam shumë i kënaqur që marr pjesë në punën e Kuvendit të shtatë të BISHZ-së nga se vet fjala BASHKIM e cila ka domethënje të madhe për tu bashkuar, sepse bashkimi bënë fuqin dhe uroj që edhe ne shqiptarët të bashkuar të shkojmë në Evropën e bashkuar.
- Zotëri Sinollah Shehu, rrëfej shkurtimisht, përshtypjet dhe fjalët e mira të një profesori Zvicërian lidhur me Turnirin në futboll të vogël të organizuar nga BISHZ më 02.05.2004 në Aarburg, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe fëmijët Zvicërian, lidhur me mënyren e organizimit të takimit dhe zhvillimin e lojtrave në këtë takim me cilësi dhe kulturë sportive.
- Për diskutim u lajmërua zotëri Gani Bala, mysafiri i ftuar, i cili filloi duke thënë si veprimtar i kahershëm më pëlqeu shumë puna e juaj organizative dhe Raporti i punës dhe për këtë u përgëzoi. Kam edhe një pyetje: A keni bashkëpunim me LAPSH-in dhe cili është bashkëpunimi i juaj me te?  
Në këtë pyetje, zotëri Xhigoli dha sqarime lidhur me organizimin e mësimit në mërgat qysh nga vitet 1990. Tregoi aktivitetin e tij si bashkëpunëtor me Universitetin e Prishtinës si dhe si mësimdhënës në Bernë në drejtimin e Informatikës si dhe kontaktet me LAPSH të cilët kanë organizuar mësimin plotësues në mërgatë. BISHZ-ja sipas strukturës organizative në përbërje të vetë ka Seksionin për arsim i cili më tepër është i fokusuar në shkollimin e mesëm dhe atë universitar, kurse LAPSH-i kujdeset për mësimin plotësues fillor të nxënësve shqiptarë që jetonjë në Zvicër. Në vazhdim, ai tha që BISHZ ka bashkëpunim dhe bashkëpunonë në mënyrë reciproke me LAPSH-in por ua kujtojmë të gjithëve, që mësimi plotësues fillor në Zvicër në gjuhën dhe kulturën shqiptare është në domenën e LAPSH-it.

#### 4. Ndarja e mirënjohjeve

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari, dr.sc. Xhigoli bëri ndarjen e 14 mirënjohjeve për intelektualët dhe veprimtarët jashtë BISHZ-së dhe në radhët e saj, të cilët e kanë ndihmuar punën e Shoqatës dhe çështjen kombëtare në tërësi dhe të komunitetit shqiptarë në Zvicër në veçanti, dhe një mirënjohje për Kryetarin e Komunës së Bujanocit për kontributë të veçantë për çështjen kombëtare. Për secilin kandidat/institucion, kryetari z. Xhigoli para të pranishmëve e ka bërë leximin e përmbajtjes së mirënjohjes. Lista e mirënjohjeve të ndara Kuvendin e shtatë është:

##### Mirënjohjet

1. **Nagip Arifi**, kryetar i Komunës në Bujanovc, Kosova Lindore
2. **Arif Ejupi**, ish-gazetar i Radio Prishtinës, veprimtar i çështjes kombëtare
3. **Lulzim Zhaku-Aliu**, donator nga Zürich
4. **Beqir Beqiri**, donator nga Rotherst
5. **Sinollah Shehu**, nënkryetar i BISHZ-së
6. **Abas Fejzullahi**, sekretar i BISHZ-së
7. **Ismet Rexhaj**, arkëtar i BISHZ-së
8. **Adnan Mehmeti**, këshilltar i BISHZ-së
9. **Skender Jusufi**, këshilltar i BISHZ-së
10. **Agim Gërbavci**, këshilltar i BISHZ-së
11. **Ramiz Shabani**, këshilltar i BISHZ-së
12. **Florim Thaçi**, këshilltar i BISHZ-së
13. **Shkumbin Rmoku**, administrator i BISHZ-së
14. **Fadil Azemi**, mjek, anëtar i BISHZ-së

#### 5. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diçka konkrete.

Pas përfundimit të kësaj pike, zotëri Sinollah Shehu shpalli të mbyllur Kuvendin, dhe i njoftoi të pranishmit për një pushim prej 10 minutash.

**Mbledhja e Kuvendit përfundoi në ora 18:20.**



## Pjesa e dytë: Promovimi i librit "Loti Alpin" i autorit Agim Shehu (18:30–19:30)

### 1. Fjala hyrëse

Fjalën hyrëse e paraqiti sekretari i BISHZ-së zotëri Abas Fejzullahi, ku në mes tjerash në vazhdim tha: Është kënaqësi kur në jetën e përditëshme përurohen vepra të ndryshme nga lëmi të ndryshme, të artit, shkencës dhe kulturës. Në këto përrurime bëhen takime dhe kokteje dhe disa nga këto vepra me kohë zhduken apo harrohen e disa fitojnë përjetësinë, sidomos nga fusha e artit dhe letërsisë. Në muajn qershor të këtij viti pranë shoqatës sonë u bë promovimi i librit të autorit të mirënjohur Vehbi Skënderit "Zvicra, Shqipëria ime" dhe sot kemi rastin ta bëjmë promovimin e librit "Loti Alpin" i autorit Agim Shehu, prania e të cilit sot këtu na nderon edhe neve. Në vazhdim, lidhur me jetëshkrimin e shkrimtarit Agim Shehu do të na njofton, z. Xhigoli

### 2. Paraqitja e shkurtër e jetëshkrimit të shkrimtarit Agim Shehu

Në këtë pikë, dr. sc. Ahmet Xhigoli, bëri një paraqitje të shkurtër të jetëshkrimit të poetit, shkrimtarit dhe publicistit nga Gjirokastra zotëri Agim Shehu. Pastaj, Abas Fejzullahi, ftoi shkrimtarin Agim Shehun që ta marr fjalën dhe njëherit të bëj leximin e disa pjesëve nga libri "Loti Alpin" me lirika të zgjedhura i cili promovohet sot.

Shkrimtari Agim Shehu, falënderoi në fillim BISHZ-së për ftesën e bërë për pjesëmarrje në Kuvendin e shtatë dhe ndien kënaqësi që vepra e tij sot përurohet këtu. E falënderoi zotëri Imer Cacaj përmes të cilit vuri lidhjet me Shoqatën BISHZ. Në vazhdim z. Agim Shehu mes tjerash tha: Nga zemra i uroj suksese BISHZ-së që të ndjek rrugën si VATRA e SHBA-s e drejtuar nga F.S. Noli dhe Faik Konica që me përkushtim e dinjitet ka punuar për kombin shqiptarë në veçanti dhe mërgatën në përgjithësi. SHBA dhe Zvicra janë miqët tanë andaj dhe ne duhet ti forcojmë dhe zhvillojmë lidhjet dhe bashkëpunimin në gjitha drejtimet e mundshme dhe ju uroj të bëheni një VATËR e vërtetë Shqiptare duke u ndalur edhe në thënjen e njohur siç tha autori se "... Pa Shqipëri s'ka Kosovë e që tani këtë thënje me të drejt po e përdorim tani se: Pa Kosovë s'ka Shqipëri..."

### 3. Leximi i disa pjesëve të librit "Loti Alpin", nga vet autori

Autori lexoi disa nga poezitë nga libri i tij me titull "Loti Alpin" të cilat u priten mjaft mirë nga të pranishmit.

#### Diskutim i hapur

Abas Fejzullahi, sekretar shpalli të hapur diskutimin lidhur me librin e përmendur.

- Për diskutim u paraqit zotëri Imer Cacaj, i cili kishte një vërejtje lidhur me jetëshkrimin e lexuar të shkrimtarit Agim Shehu nga z. Xhigoli, lidhur me fjalën ku përmendet diktatura, ishte i mendimit se është dashur që mos të përmendet apo në ndonjë formë tjetër (diplomatike) apo të zbutur.
- Pergjegja nga z. Xhigoli: ai mes tjerash tha se unë jetëshkrimin e askujt se ndryshoj dhe e lexoi një për një si më është dhënë.
- Lidhur me këtë fjalën e mori edhe vet autori dhe bëri edhe disa sqarime dhe plotësime, lidhur me jetëshkrimin e tij.
- Abas Fejzullahi, duke përfunduar pjesën e dytë, i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në diskutimet e tyre konstruktive duke pasur për bazë demokracinë si objektiv.

## Pjesa e tretë: Darka e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar (19:30 – 21:30)

Pikrisht në orën 19:30 përfundoi programi sipas renditjes së parapar dhe kohës.

Dr. sc. Ahmet Xhigoli, kryetar, i ftoi të pranishmit në darkan e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar, duke u dëshiruar çaste të këndëshme.

Darka ishte modeste dhe kaloi me një atmosferë të këndëshme për të gjithë dhe pati falënderime dhe përgëzime nga të pranishmit për punën e Shoqatës dhe organizimin në veçanti.

*Udhëheqës i protokolit: Abas Fejzullahi  
Solothurn, 21 nëntor 2004*